



Crna Gora / Mali i Zi  
Opština Ulcinj  
Komuna e Ulqinit  
Sekretariati për bujqësi, zhvillim rural dhe ekologji

Adresa: Bul. Skenderbega/Skenderbeu  
85360 Ulcinj/Ulqin, Crna Gora/Mali i Zi  
e-mail: zecarije.sulejmanovic@ul-gov.me

Br./Nr. 17-\_\_\_\_\_

Ulcinj/Ulqin, 21.11.2022. god. vit

Sekretariati për bujqësi, zhvillim rural dhe ekologji në bazë të nenit 24 të Vendimit mbi masat nxitëse për zhvillimin e bujqësisë ("Fleta zyrtare MZ - rregulloret komunale "nr. 46/16 dhe nr. 18/19), në pajtueshmëri me Buxhetin e komunës së Ulqinit dhe me Planin e shfrytëzimit të mjeteve për mbështetje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2022 shpall:

## **THIRRJEN PUBLIKE** **Për ndarjen e mjeteve mbështetëse për zhvillimin** **e ullishtarisë për vitin 2022**

### **SUBJEKTI I THIRRJES**

Në kuadër të masave mbështetëse për shfrytëzimin e mjeteve për zhvillimin e ullishtarisë për vitin 2022, përfituesi realizon të drejtën e mjeteve mbështetëse për investime që kanë të bëjnë me mbjelljen e ullishtave të reja dhe furnizimin me pajisje për zhvillim të ullishtarisë.

### **PËRKUFIZIMI I PËRDORUESVE TË MBËSHTETJEVE**

Të drejtën e mbështetjes sipas kësaj thirrjeje publike e kanë personat fizikë dhe juridikë. Personat fizikë duhet të jenë të rregjistruar në Rregjistrin e amvisërive bujqësore për prodhimin e ullinjëve ose/dhe në Rregjistrin e prodhuesve të vajit të ullirit në përputhje me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural („Fl. zyrtare e MZ“, nr. 56/09,34/14, 1/15 i 30/17) në momentin e aplikimit, dorëzimit të Kërkesës. Kur është fjala për persona juridikë ata duhet të kenë veprimtarinë primare nga sektori A: Bujqësia, pylltaria, peshkimi, në pajtueshmëri me Ligjin për klasifikim të veprimtarive („Fl. zyrtare e MZ“, nr. 18/11). Aplikanti duhet të ketë vendbanimin, gjegjësisht selinë, në territorin e komunës së Ulqinit dhe veprimtarinë bujqësore ta ushtrojë në komunën e Ulqinit.

### **INVESTIMET E PRANUESHME**

Investimet që mbështeten me këtë Thirrje janë:

- Furnizimi me fidanë për ullishta të reja;
- Blerja e mekanizimit dhe paisjeve për vjelje dhe mirëmbajtje të ullinjëve (shkundëse, rrjetat për vjelje, kositëse për mirëmbajtje të ullishtës, pajisje për bluarjen e degëve, pajisje për krastitje, pajisje për deponimin e vajit të ullirit - enë inoksi);

### **SHUMA E MBËSHTETJES**

Për këto mbështetje, sipas Planit të përdorimit të mjeteve janë të dedikuara gjithsejt **13.000,00€** për vitin 2022.

Shuma e mbështetjes është 50% pa TVSH, prej shpenzimeve totale të pranueshme të investimeve,

Shuma maksimale për aplikantin është deri në **500,00 €**.

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT**

**Kjo mbështetje mund të përfitohet nëse aplikanti:**

- i plotëson të gjitha kushtet sipas Vendimit për masat mbështetëse për zhvillim të bujqësisë
- nuk ka detyrime tatimore të pashlyera ndaj administratës vendore
- për të njëjtin investim nuk ka përfituarur mjete nga Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ujërave

Me këto masa **nuk mbështeten**:

- blerja e pajisjeve të përdorura,
- blerja e fidaneve dekorative,
- shpenzimet tatimore, doganore, importi, taksat administrative dhe të ngjashme,
- blerja ose marrja me qira e tokës bujqësore dhe objekteve ekzistuese,
- kostot e kapitalit qarkullues dhe kostot operative,
- kostoja e punës së vet (rrogat, kontributet).

### **KRITERET SPECIFIKE TË PRANIMIT**

Aplikantët duhet të ketë në pronësi së paku 1000 m<sup>2</sup> tokë bujqësore ose të kenë më shumë se 50 rrënjë ullinj.

Nëse investimi bëhet për pajisje për përpunimin e ullinjëve, ai do jetë i pranueshëm për aplikantët që kanë së paku 50 rrënjë ullinj frytdhënës.

Nëse investimi bëhet për fidane, kërkesa duhet të shoqërohet me deklaratën e cilësisë së fidaneve. Deri në momentin e pagesës së mjeteve mbështetëse për ullishtë të re ajo duhet të jetë e regjistruar në Rregjistrin e amvisërive bujqësore.

Nëse bëhet fjalë për ullishtë të re aplikanti duhet të ketë në pronësi së paku 1000m<sup>2</sup> tokë bujqësore dhe në të të mbillen së paku 30 fidane të reja të ullirit.

### **DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kërkesa për pranimin e mbështetjes/investimit;
- Vendimi i regjistrimit të amvisërisë bujqësore që e lëshon Ministria e bujqësisë pylltarisë dhe ujërave;
- Vendimi nga Rregjistri i prodhuesve të ullinjëve dhe/ose Rregjistri i prodhuesve të vajit të ullirit;
- Për persona juridikë ekstrakti nga CRPS (rregjistri qendror për subjekte ekonomike);
- Dëshmia e pronësisë (fleta poseduese, kontrata e shfrytëzimit),
- Deklarata e vërtetuar se për këtë mbështetje nuk janë marrur mjete nga organet shtetërore ose administrata lokale;
- Fotokopja e letërnjoftimit të aplikantit;
- Vërtetimi se aplikanti nuk ka detyrime tatimore ndaj organeve të administratës lokale;
- Një kopje e fletëgarancisë për pajisjen e blerë;
- Dëshmia se paisja është paguar në formën e:
  - faturës fiskale me dëshmi pranimi me emrin e blerësit;
  - në rastin e pagesës përmes xhiro-llogarisë (pagesat llogaritare) fatura e vërtetuar (e pagesës) për transferimin e mjeteve shitësit dhe fatura e verifikuar;
  - dëshmitë tjera specifike të parapara me kriteret specifike të pranueshmërisë.

### **SI TË DËRGONI KËRKESËN**

Formularin e Kërkesës për mbështetje në ullishtari për vitin 2022 mund ta merrni në zyrën e Sekretariatit për bujqësi, zhvillim rural dhe ekologji si dhe në Zyrën e qytetarëve të komunës së Ulqinit.

Formularin e plotësuar të kërkesës dhe dokumentacionin përcjellës e dërgoni me postë në adresën:

**Sekretariati për bujqësi, zhvillim rural dhe ekologji**  
**Kërkesë sipas Thirrjes publike për ndarjen e mjeteve**  
**mbështetëse për aktivitetet e prodhimit dhe zhvillimit**  
**të ullishtarisë për vitin 2022**  
**Bulevardi Skënderbeu,**  
**85360 Ulqin**

**Afati i dërgimit të kërkesës është 5 dhjetor 2022**, gjegjësisht deri në ndarjen e mjeteve të dedikuara për realizimin e këtij programi.

Nëse mjetet shpenzohen para datës 5 dhjetor 2022, Thirrja publike do të mbyllet për çka do të informohen prodhuesit.

### **PROÇEDURA E REALIZIMIT**

Sekretariati do të vizitojë aplikantët që kanë dorëzuar dokumentacionin, para se të lejohet mbështetja financiare, dhe bën verifikimin në vend të të dhënave dhe kushteve të parapara me Vendimin për masat mbështetëse për zhvillim të bujqësisë dhe me këtë Thirrje dhe për këtë harton procesverbalin me vlerësim dhe mendim për plotësimin e kushteve për përfitimin e mjeteve mbështetëse financiare.

Nëse shfrytëzuesi nuk lejon ose ndalon punën e Sekretariatit në terren, ose në ndonjë mënyrë tjetër ndikon në punën e tij, kërkesa e tij do të refuzohet.

Në bazë të dokumentacionit të dërguar dhe shqyrtimit në vend, Sekretariati konstaton a janë plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës për mjete dhe me vendim lejon pagesën e mjeteve mbështetëse financiare.

Shfrytëzuesit e kësaj të drejte duhet t'i shpenzojnë mjetet për atë që janë dedikuar mjetet mbështetëse dhe nuk mund ti tjetërsojnë ato, ose t'ia japin dikujt tjetër për përdorim investimin sipas kësaj kërkesë, në periudhën 5 vjeçare prej ditës së përfitimit.

Kontrollin e shpenzimit të mjeteve të miratuara për mbështetje në kontinuitet do ta ushtrojë organi kompetent për punët e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Shfrytëzuesit që përdorin mbështetjen për qëllime jo të synuara, me vendim të organit kompetent, humbasin të drejtën e mbështetjes, për çka Sekretariati nxjerr vendim të posaçëm me të cilin urdhërohet përfituesi të kthejë mjetet.

Në këtë rast, përfituesi obligohet të kthejë mjetet e përfituara plotësisht në afatin prej 30 ditëve prej marrjes së vendimit.

Personat që kanë dhënë të dhëna jo të sakta në kërkesën e tyre, e të cilat i konstaton organi kompetent, nuk kanë të drejtë në masat mbështetëse.

Përfituesit duhet të ruajnë dokumentacionin në bazë të së cilit kanë fituar këtë të drejtë për masë mbështetëse, më së paku pesë vjetë prej ditës së marrjes së mjeteve mbështetëse. Aplikanti kërkesa e të cilit refuzohet do të lajmërohet për shkaqet e refuzimit. Normat ndëshkuese janë të normuara në nenin 31 dhe 32 të Vendimit për masat mbështetëse për zhvillimin e bujqësisë.

### **VËREJTJE:**

Kërkesat e arritura pas afatit Sekretariati nuk do ti shqyrtojë.

Sekretariati do të pranojë si të vlefshme faturat e vitit 2022 deri në datën e skadimit të afatit të thirrjes publike (05.12.2022).

Informatat në lidhje me Thirrjen publike mund të merren në e-mail [zecarije.sulejmanovic@ul-gov.me](mailto:zecarije.sulejmanovic@ul-gov.me) ose personalisht në zyrën e Sekretariatit.